



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 376 Prot.

Tiranë, më 09. 03 . 2023

V E N D I M

Nr. 35, datë 09. 03 . 2023

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën nr. 121, datë 01.07.2021, të M. N, A. M dhe A. R, përfaqësuar nga Federata e Sindikatave të Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë³, ku pretendohet diskriminim për shkak të “përkatësisë në një grup të veçantë”⁴, nga ana e Kürüm International sh.a.

Pas shqyrtimit përfundimtar të ankesës së mësipërme, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

Sipas informacionit të dhënë, FSPISH ka nënshkruar një kontratë kolektive pune, me datë 07.01.2019, me afat 3-vjeçar, me kompaninë Kürüm International sh.a., për punonjësit e heceve Ulëz-Shkopet dhe Bistrice 1 & 2. FSPISH pretendon se, punëdhënësi Kürüm International sh.a. ka vepruar në kundërshtim me këtë kontratë, duke ndërmarrë një sërë reformash për largimin e disa punonjësve nga puna, në mënyrë të pamotivuar, të paarsyetuar dhe në kundërshtim me parashikimet e Kodin e Punës mbi pushimet kolektive nga puna.

E ndodhur në këto rrethana, FSPISH ka ndërmarrë një sërë aksionesh dhe veprimtarish sindikale, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me statutin e Shoqërisë, me qëllim ndalimin e këtyre reformave për punonjësit, që janë anëtarë të kësaj Federate.

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose si Komisioneri.

³ Në vijim do t'i referohemi me akronimin FSPISH.

⁴ Të tre ankesit janë anëtarë të FSPISH dhe mbajnë pozicionet e Nënkryetarit, Sekretarit dhe anëtarit të Këshillit Sindikal.

Sipas palës ankuese, punëdhënësi ka ndërmarrë “sanksione” ndaj drejtuesve të FSPISH duke u dhënë masa disiplinore dhe duke i pezulluar pa afat nga detyra, nën pretekstin e pjesëmarrjes në greva të paligjshme.

Për sa më sipër, M. N, i cili është Nënkyetar i Këshillit Sindikal të Heceve Ulëz- Shkopet, i është dhënë masa disiplinore “*Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna*” dhe në vijim është pezulluar pa afat nga detyra.

A. M, i cili mban pozicionin e Sekretarit të Këshillit Sindikal të Heceve Ulëz-Shkopet i është dhënë masë disiplinore “*Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna*” e “*Ulje në detyrë deri në gjastë muaj*”, si dhe në vijim është pezulluar pa afat nga detyra.

A. R, i cili mban pozicionin e anëtarit të Këshillit Sindikal të Heceve Ulëz-Shkopet i është dhënë masë disiplinore “*Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna*”, si dhe në vijim është pezulluar pa afat nga detyra.

Në këtë kontekst, FSPISH sqaron se aktivitetet e organizuara nuk kanë qenë greva, pasi në asnjë rast nuk është ndërprerë puna dhe prodhimi, përkundrazi veprimtaritë e Federatës kanë konsistuar në zbatimin e së drejtës kushtetuese për t’u ngritur në protesta dhe mitingje, përpara selisë së punëdhënësit. Subjekti ankues pretendon se Kürüm International sh.a. ka vepruar në të njëjtën linjë presioni me punonjësit e tjerë, që janë anëtarë sindikate duke kërcënuar për mosrinnovim kontrate, në mënyrë që ata të mos marrin pjesë në protesta. E gjithë kjo, sipas subjektit ankues, është një formë hakmarrjeje ndaj FSPISH, pasi drejtuesit e sindikatës kanë kërkuar transparencë për blerjen e heceve nga kjo Kompani.

I. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë joshteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të *përkatësisë në një grup të veçantë*” duke përcaktuar se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.*”

Neni 5, i ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikon ndalimin e diskriminimit për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji. Sipas këtij neni ndalohej gjithashtu mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, të një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje, që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Neni 7, i LMD, të ndryshuar, parashikon shprehimisht: “1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”

Në Kreun III, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ky ligj në nenin 12, pika 1, gërma c) parashikon shprehimisht se: “1. Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:c) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve, trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

Hapat procedurialë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

1. Pas analizimit të ankesës nr. 121, datë 01.07.2021, të paraqitur nga M. N, A. M dhe A. R, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
2. Mbështetur në nenin 33, pika 7⁵, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri, me shkresën nr. 990/2, datë 23.07.2021, ka kërkuar informacion, nga ana e Kürüm International sh.a. lidhur me pretendimet e subjekteve ankues.

⁵ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar të KMD-së, Kürüm International sh.a. dërgoi shkresën nr. 515 prot., datë 02.08.2021, nëpërmjet së cilës bën me dije se kjo Shoqëri është e regjistruar si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me nr. K02727230T NIUS/NIPT-i. Aktiviteti i kësaj Shoqërie, ndër të tjera është edhe prodhimi nga burimet ujore të energjisë elektrike dhe shitblerja e saj.

Në shkresën e sipërcituar theksohet fakti se Kürüm International sh.a është pronar dhe zotërues i vetëm i Hec Ulëz, Hec Shkopet, Hec Bistrica 1 dhe Hec Bistrica 2. Referuar legjislacionit respektiv, Shoqëria Kürüm International sh.a ka nënshkruar kontratën kolektive të punës, të datës 07.01.2019, me FSPISH. Sipas nenit 64, paragrafi i fundit, të kësaj kontrate, efektet e saj fillojnë në datën 01.01.2019 dhe përfundojnë ato në datën 01.01.2022.

Përgjatë kohëve të fundit, Shoqëria ka kryer shumë investime pranë Heceve Ulëz dhe Shkopet, investime që kanë të bëjnë me rinovimin tërësor të impianteve, paneleve, agregatëve dhe nënstracionit elektrik në Hidrocentralin e Shkopetit. Këto investime kanë sjellë shkallën më të lartë të automatizimit dhe komandimit në distancë të proceseve teknologjike në këto dy hidrocentrale. Këto investime, domosdoshmërisht kërkonin dhe ristrukturim të fuqisë punëtore. Për situatën e sipërcituar, Shoqëria vuri në dijeni FSPISH, nga ku më pas ndërmjet tyre është nënshkruar Akt Marrëveshja nr. 126 prot., datë 26.02.2020. Sipas kësaj Aktmarrëveshje, palët nënshkruese dhe më e rëndësishmja FSPISH, është njohur tërësisht me situatën e vlerësuar më sipër dhe kanë rënë dakord si më poshtë:

“Riorganizimi dhe ristrukturimi i fuqisë punëtore do të bëhet sipa studimit të bërë nga “Kürüm International” SHA dhe se do të realizohej në 2(dy) faza si më poshtë:

- i. Faza e Parë do të realizohej nga apo punëdhënësi gjatë periudhës Mars-Qershor 2020 në të cilën parashikohej zgjidhja e kontratës së punës me jo më tepër se 9 (nëntë) punonjës (nuk përfshihen punonjësit që mbushin moshën e pensionit gjatë vitit 2020);*
- ii. Faza e dytë do të realizohej nga punëdhënësi gjatë periudhës Mars-Qershor 2021 në të cilën parashikohej zgjidhja e kontratës së punës me jo më tepër se 9 (nëntë) punonjës (nuk përfshihen punonjësit që mbushin moshën e pensionit gjatë vitit 2020);”*

Faza e parë është realizuar dhe palët nënshkruese të Akt-Marrëveshjes së mësipërme nuk kanë patur ndonjë kontestim. Ndërkohë që pas fillimit të zbatimit të fazës së dytë, Këshilli Sindikal i Heceve Ulëz-Shkopet, pasi ka marrë dhe miratimin e Sekretarit të Përgjithshëm të saj, njofton me email për një vendimarrje për realizimin e një greve nga ana e tyre në datën 26.05.2021, ora 10:00. Me anë të këtyre akteve, FSPISH njoftonte si shkak për zhvillimin e grevës, situatën e krijuar për largimin nga puna të punonjësve të Heceve Ulëz dhe Shkopet, për shkak të reformës së nisur nga shoqëria. Me anë të shkresës nr. 317 prot., datë 25.05.2021, Kürüm International sh.a. e njoftoi FSPISH, duke i cilësuar se greva që kërkojnë të bëjnë është e paligjshme, nuk plotëson elementët 2, 3 dhe 4 të nenit 197/3 të Kodit të Punës, si dhe ato të kontratës kolektive të muajit janar 2019, mbi *“sigurimin e paqes absolute”*, si dhe i kërkoi ndërprerjen e çdo lloj veprimi apo mosveprimi që kishte të bënte me këtë grevë të paligjshme, duke i kujtuar që Shoqëria po vepronte në bazë të Akt-Marrëveshjes nr. 126, datë 26.02.2020.

Kürüm International sh.a. thekson faktin se pavarësisht sa më sipër, FSPISH e organizoi grevën më datë 26.05.2021, për të cilën kanë folur edhe mediat kombëtare. Në kushtet kur, Shoqëria e konsideroi grevë të paligjshme, depozitoi në datën 03.06.2020, kërkesë padi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me objekt: *“Deklarimin e grevës së datën 26.05.2021 të zhvilluar dhe organizuar nga FSPISH si grevë të paligjshme”*. Në bazë të akteve të sjella nga FSPISH për njoftimin e grevës nuk rezulton që në zbatim të nenit 197/3, paragrafi i dytë, të kishte për qëllim nënshkrimin apo zbatimin e një kontrate kolektive ose plotësimit e ndonjë kërkesë që buron nga marrëdhëniet e punës dhe që nuk rregulloheshin nga kontrata kolektive e punës. Por, edhe nëse do të kishte një problematikë të tillë, në bazë të nenit 169, paragrafi 2, i Kodit të Punës, ku parashikohet se: *“Secila nga palët zbaton detyrimin e paqes së punës vetëm kur palët kanë rënë dakord për të shprehimisht me shkrim. Detyrimi i paqes është absolut vetëm kur palët kanë rënë dakord për të shprehimisht”*. Gjithashtu në nenin 64 të Kontratës Kolektive të Punës, së datës 07.01.2019, është cilësuar qartë se: *“Me nënshkrimin e kësaj kontrate, palët bien dakord për sigurimin e paqes absolute, për çështje të tjera, të cilat nuk kanë të bëjnë me respektimin dhe zbatimin e detyrimeve të kësaj kontrate”*.

Kürüm International sh.a. sqaron se greva e datës 26.05.2020, e organizuar dhe kryer nga FSPISH dhe Këshilli i saj Sindakal nuk gjen asnjë mbështetje ligjore, pasi kërkesat e pretenduara nga sindikata janë në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Punës, me Kontratën Kolektive në fuqi, me Akt-Marrëveshjen e lidhur për reformën e fuqisë punëtore (kërkesat për rritje page në masën 60%, përfitimi i benefiteve të kontratës kolektive të vitit 2013 me punëdhënësin shtetëror KESH, anulimi i reformës së fuqisë punëtore etj.), duke shkelur kështu paqen absolute për të cilën ka nënshkruar kontratën kolektive të datës 07.01.2019 dhe për të cilën ka marrë zotimet e saj.

Për më tepër, kushti i deklaruar nga FSPISH se pranon të ulet në bisedime vetëm me z. Hasmet Kürüm, ish aksioner i Shoqërisë, ka penguar plotësisht mundësinë e bisedimeve të FSPISH me përfaqësuesit administrativë të cilët janë edhe nënshkrues të Kontratës Kolektive të Punës dhe Akt-Marrëveshjes, në cilësinë e përfaqësuesve të Kürüm International sh.a.

Në shkresën e kësaj Shoqërie theksohet fakti se konflikti që FSPISH po mundohet të krijojë, ka të bëjë me fillimin e procedurës së rregullt dhe ligjore nga ana e Kürüm International sh.a. për zgjidhjen e kontratës së punës me 7 (shtatë) punonjës, në zbatim të përcaktimeve dhe kriterëve të parashikuara në Akt-Marrëveshjen e lidhur për fazën e II-të të shkurtimeve, të përcaktuar dhe të miratuar prej saj si përfaqësuese e punonjësve të Heceve Ulëz dhe Shkopet, i cili është zgjidhur me anë të bisedimeve dhe e ka konkretizuar me një marrëveshje të shkruar. Greva e datës 26.05.2021 nuk mund të ushtrohej, pasi nuk ishte e siguruar kryerja e shërbimit minimal, mbështetur në nenin 197/6 të Kodit të Punës.

Kürüm International sh.a. ka sqaruar se ka dijeni mbi faktin se M. N, me detyrë Personel Turni është Nënkyetar i Këshillit Sindikal të Heceve Ulëz-Shkopet. Të njëjtin fakt, Kürüm International sh.a. e pohon edhe për dy ankuesit e tjerë. Në vijim, Shoqëria thekson faktin se duke patur parasysh faktin se z. N mbante pozicionin e sipërcituar, nuk është përfshirë në listat e shkurtimeve/ristrukturimit edhe pse pozicioni i tij i punës është shkurtuar (pozicioni i punës-mekanik turni) dhe iu dha mundësia e një pozicioni tjetër pune.

Ndaj A. M është marrë një masë disiplinore e mëparshme, nëpërmjet shkresës nr. 595 prot., datë 30.05.2015 (për fallsifikim të dokumenteve shkollore), por duke patur parasysh faktin se ai mbante pozicionin e Sekretarit të Këshillit Sindikal të Heceve Ulëz-Shkopet, ndaj tij nuk është marrë masa ekstreme e pushimit nga puna, apo padi për ndjekje penale ndaj tij, por në mirëkuptim me drejtuesit e FSPISH është marrë masa disiplinore “Paralajmërim për pushim nga puna”.

Lidhur me arsyet e vendimeve për marrjen e masave disiplinore, Kürüm International sh.a. sqaron se anëtarët e Këshillit Sindikal, të cilët përbënin edhe komisionin e grevës janë paralajmëruar për organizimin, drejtimin e grevës së paligjshme, si dhe veprimeve të kryera në kundërshtim me ligjin. Bojkotimi i punës nga personeli mirëmbajtës i makinerive dhe pajisjeve, duke përfshirë edhe përgjegjësin e mirëmbajtjes mekanike A. M, me gjithë thirrjet e vazhdueshme të punëdhënësit, ka çenuar sigurinë e Hidrocentraleve në Ulëz dhe Shkopet.

Për sa më sipër, në bazë të nenit 50, pikat 2-3 dhe nenit 51, gërma d), të Kontratës Kolektive të Punës, A. M i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, si dhe “Ulje në detyrë deri në 6 muaj”, nëpërmjet shkresës nr. 339 prot., datë 29.05.2021, të Administratorit të shoqërisë. Kjo masë është dhënë pasi në datën 26.05.2021 është konstatuar se punëmarrësi A. M, me detyrën Përgjegjës i Mirëmbajtjes Teknike ka braktisur vendin e punës pa siguruar as kryerjen e shërbimeve të domosdoshme minimale për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e makinerive dhe pajisjeve, si dhe pa marrë as leje nga eprorët për largimin e tij nga vendi i punës, për shkak të riorganizimit dhe pjesëmarrjes në grevë, me pretendimin e tyre për plotësimin e disa kërkesave të pajustificuara dhe abuzive nga punëdhënësi. Këto kërkesa abuzive nuk kanë të bëjnë me respektimin dhe zbatimin e kontratës kolektive në fuqi dhe janë në kundërshtim me dispozitat e kësaj kontrate, në të cilën palët kanë rënë dakord për sigurimin e paqes absolute, në përputhje me parashikimet e nenit 169, pika 2, të Kodit të Punës. Gjithashtu, kërkesa për ndalimin e ristrukturimit të fuqisë punëtore nga punëdhënësi, bie ndesh me dakordësinë e shprehur nga përfaqësuesit e sindikatës dhe punëdhënësit në Akt-Marrëveshjen e lidhur për kryerjen e refomës së fuqisë punëtore në hidrocentralet Ulëz Shkopet, në të cilën nënshkrues është edhe vetë punonjësi A. M, në cilësinë e përfaqësuesit të Sindikatës.

Lidhur me M. N, Kürüm International sh.a. sqaron se atij i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, nëpërmjet shkresës nr. 336 prot., datë 29.05.2021, të Administratorit të Shoqërisë. Motivacioni i dhënies së kësaj mase ka qenë se punëmarrësi me detyrën personel turni, ka kryer veprime që bien ndesh me paqen absolute në punë, për shkak të organizimit dhe pjesëmarrjes në grevë.

Lidhur me A. R, Kürüm International sh.a. sqaron se atij i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, nëpërmjet shkresës nr. 338 prot., datë 29.05.2021, të Administratorit të Shoqërisë. Motivacioni i dhënies së kësaj mase ka qenë se punëmarrësi me detyrën mekanik remonti, ka kryer veprime që bien ndesh me paqen absolute në punë, për shkak të organizimit dhe pjesëmarrjes në grevë.

Edhe për dy punonjësit e sipërcituar, shoqëria ka theksuar faktin se dy punonjësit kanë kryer veprime që bien ndesh me paqen absolute në punë, për shkak të organizimit dhe pjesëmarrjes në grevë, me

pretendimin e tyre për plotësimin e disa kërkesave të pajustificuara dhe abuzive nga punëdhënësi. Këto kërkesa abuzive nuk kanë të bëjnë me respektimin dhe zbatimin e Kontratës Kolektive të Punës në fuqi dhe janë në kundërshtim me dispozitat (neni 64, pg. 3) të kësaj kontrate, mbi të cilën palët kanë rënë dakord shprehimisht për sigurimin e paqes absolute, në përputhje me parashikimet e nenit 169, pika 2 të Kodit të Punës. Në shkresë theksohet fakti se kërkesa për ndalimin e ristrukturimit të fuqisë punëtore nga punëdhënësi, bie ndesh me dakordësinë e shprehur nga përfaqësuesit e sindikatës dhe punëdhënësit në Akt-Marrëveshjen e lidhur për kryerjen e reformës së fuqisë punëtore në hidrocentralet Ulëz Shkopet, në të cilën janë nëshkrues edhe dy ankuesit, në cilësinë e përfaqësuesve të Sindikatës.

Në shkresën e Kürüm International sh.a. theksohet gjithashtu edhe fakti se deklarimi i përfaqësuesve të sindikatës për kryerjen e veprimeve haptazi në kundërshtim me ligjin, të cilat kanë të bëjnë me bllokimin e aktivitetit të hidrocentraleve, braktisjen e punës, cënon rëndë marrëdhënien e mirëbesimit midis punëdhënësit dhe punëmarrësit.

Lidhur me çështjen e pezullimit pa afat të M. N, Kürüm International sh.a. sqaron se gjatë ushtrimit të grevës, nga ana e kësaj shoqërie është marrë vendimi nr. 365 prot., datë 04.06.2021, për pezullim detyrimesh dhe të drejtash që burojnë nga marrëdhënia e punës me një nga drejtuesit e Sindikatës, M. N, në referencë të nenit 197/8 e vijues të Kodit të Punës. Ky pezullim ishte i përkohshëm dhe do të vazhdonte për aq kohë sa do të vazhdonte greva. Pas marrjes së njoftimit në datën 22.06.2021 për vendimin nr. 1163 prot., datë 21.06.2021, të Këshillit Sindikal për përfundimin e grevës, duke filluar nga data 23.06.2021, të tre përfaqësuesit e Këshillit Sindikal vazhdojnë të jenë në marrëdhënie pune, pra u është hequr masa e pezullimit. Kjo provohet me listëpagesat e kryera, të cilat janë depozituar në cilësi prove, për periudhën maj-qeshor 2021.

Në këtë kontekst, Kürüm International sh.a sqaron se masat disiplinore të marra janë në përputhje me Kodin e Punës.

- Në vijim, në datën 06.08.2021, shkresa nr. 515 prot., datë 02.08.2021, e Kürüm International sh.a. iu dërgua për dijeni FSPISH me e-mail. Federata dërgoi në përgjigje të saj, shkresën nr. 1171, datë 06.08.2021, ku shprehet se Kompania Kürüm International sh.a. vazhdon haptazi të diskriminojë punonjësit dhe Këshillin Sindikal të FSPISH, duke abuzuar me informacionin e dhënë dhe duke vetëgjykuar këta punonjës.

FSPISH sqaron se sikurse citohet edhe nga kjo Shoqëri, në shkresën e tyre drejtuar KMD-së, ndërmjet tyre është nënshkruar Kontrata Kolektive e Punës, e cila i shtrin efektet e saj për të gjithë punonjësit e Heceve Ulëz-Shkopet dhe Bistrica 1 & 2.

FSPISH thekson faktin se, konflikti ndërmjet tyre e ka bazën tek reformat e nisura për ristrukturimin e fuqisë punëtore nga ana e Kürüm International sh.a. për shkak të rehabilitimit të Heceve Ulëz dhe Shkopet. Në shkresë, sqarohet se pasi filloi faza e parë e ristrukturimit të fuqisë punëtore, Këshilli Sindikal u vu në dijeni të shumë padrejtësive dhe mungesës së transparencës nga ana e kompanisë, ku punonjësit shenjoheshin sipas dëshirës së drejtorit të Burimeve Njerëzore të Kürüm International, Gj.M., me një telefonatë apo dhe me ndërhyrje të tjera. Pas informacionit të mbledhur nga punonjësit e këtyre

heceve në takimet sindikale, FSPISH pas shumë përpjekjesh dhe telefonatash të pasuksesshme, për të biseduar paraprakisht rreth këtyre abuzimeve dhe uljen në bisedime, i drejtohet me shkresën nr. 1123 prot., datë 18.01.2021 kompanisë Kürüm International sh.a. ku i bëhen të ditura problematikat e lindura për shkak të reformës dhe i kërkohet takim me të duke qenë të bindur dhe duke i besuar bashkëpunimit korrekt që Sindikata ka patur për vite me rradhë me këtë Kompani.

Sipas Gj. M. nënshkrimi i marrëveshjes ishte dhe miratimi për Kompaninë që ajo të veprojë sipas orientimeve dhe studimeve të kryera nga ai vetë dhe të përjashtonte çdo lloj bisedimi të mëpasshëm të domosdoshëm me Sindikatën. Por, FSPISH menjëherë kërkoi pezullimin e reformës dhe rrjedhimisht rrëzimin e kësaj Akt-Marrëveshjeje, që nuk plotësoi as kriterin e vetëm, atë të “zbutjes së pasojave sociale”.

Në shkresë pretendohet se përpjekjet e Sindikatës për të biseduar me Gj. M., me detyrë, Drejtor i Burimeve Njerëzore pranë Kürüm International sh.a. dhe për ta zgjidhur çështjen me marrëveshje, nuk patën sukses, pasi Kompania dha përgjigje negative e deri në kërcënime se do të shkatërroheshin si sindikatë.

Në vijim, FSPISH sqaron se ka kërkuar takim nëpërmjet kërkesës së datës 18.01.2021, me H. K, pronar i shoqërisë Kürüm International, por nuk ka marrë asnjë përgjigje nga kjo Shoqëri. E njëjta gjë ndodhi edhe pas e-mailit të dërguar në datën 27.02.2021.

FSPISH sqaron se duke parë gjendjen e rënduar të punonjësve dhe pasigurinë e tyre për shkak se emrat në lista ndërroheshin nga dita në ditë, pa asnjë kriter dhe pa biseduar me Sindikatën, i ka kërkuar shoqërisë Kürüm International sh.a. nëpërmjet shkresës nr. 1136 prot., datë 01.03.2021, anulimin e kësaj reforme dhe ulje për bisedime për të gjetur një zgjidhje nëpërmjet dialogut. Por sërish nuk ka patur asnjë përgjigje nga ana e Kürüm International sh.a.

Në këto kushte, FSPISH ka njoftuar Kompaninë dhe organet kompetente, sipas parashikimeve të legjislacionit shqiptar për tubimet, për një tubim paqësor në hyrje të Heceve në datën 08.03.2021, për të sensibilizuar kompaninë për t’u ulur në bisedime me Sindikatën dhe për të zgjidhur problemet me anë të dialogut.

Në këtë rast, Kompania ka reaguar menjëherë, me anë të një komunikimi telefonik me T. K, Sekretar i Përgjithshëm i FSPISH, të bërë nga një ndërmjetës dhe ish-bashkëpunëtor i Kürüm International, K. Z., me anë të së cilit K. K kërkoi pezullimin e protestës dhe anulimin e reformës nga ana e Kompanisë. Në mbledhjen e datës 08.03.2021, Hec Ulëz, T. K i komunikoi Këshillit Sindikal dhe anëtarëve të saj në takim, rreth vendimit të z. Hasret Kürüm.

FSPISH i kërkoi kompanisë Kürüm International një takim, i cili u zhvillua në datën 17.03.2021, takim në të cilin morën pjesë përfaqësues të Sindikatës dhe Administratori i Kürüm International sh.a. dhe përfaqësues të tjerë të kësaj Kompanie. Në këtë takim, Kompanisë iu kërkua të lëshojë një letër zyrtare për negociimin e bërë dhe ndërprerjen e reformës. Administratori i Kürüm International sh.a. është shprehur se në kushtet kur drejtori i burimeve njerëzore të Kompanisë nuk ndodhej në punë për arsye

shëndetësore, e shihte jo etike që Kompania të vepronte në mungesë të tij për të dërguar letra zyrtare. Megjithatë, Administratori i Shoqërisë i siguroi përfaqësuesit e Sindikatës se sapo drejtori i burimeve njerëzore do të kthehej në punë, shkresa zyrtare do të dërgohej në adresë të Sindikatës.

Pas këtij lajmi, situata e punonjësve është qetësuar, deri në momentin e rikthimit në punë të drejtorit të burimeve njerëzore të Kürüm International sh.a., i cili filloi menjëherë procedurat për zgjidhjen e kontratave të punës së punonjësve për efekt të reformës dhe në zbatim të Aktmarrëveshjes, e cila ishte kundërshtuar nga ana e FSPISH dhe si e tillë konsiderohej e pavlefshme.

Në vijim, Sindikata u mundua të krijonte lidhje bashkëbisedimi me Kürüm sh.a., por pa dobi. Në këto kushte, në datën 24.05.2021, FSPISH zhvilloi një takim me Këshillin Sindikal të Heceve Ulëz-Shkopet, në vijim të së cilës iu dërgua shkresë zyrtare z. Hasmet Kürüm, për një takim urgjent, pasi ishte marrë vendim për fillimin e një proteste të dytë.

Pas njoftimit zyrtar të FSPISH për protestën që do të zhvillohej në datën 26.05.2021, Kompania e përfaqësuar nga Gj. M. filloi sulmin për anëtarët dhe drejtuesit e Sindikatës në këto Hece, duke i kërcënuar ata për pushim nga puna, nëse do të merrnin pjesë në protestë.

Në vijim, Kürüm International sh.a. i ktheu përgjigje Sindikatës, me anë të shkresës nr. 317 prot., datë 25.05.2021, duke e quajtur atë në mënyrë abuzive “grevë” dhe duke vetëgjykuar si të paligjshme dhe duke i vetëshpallur fajtorë drejtuesit e Sindikatës, duke u mbështetur në pretendimin se janë mbështetur në Aktmarrëveshje, si dhe në nenin 64, paragrafi 3 të kontratës kolektive të punës. Në këtë kontekst, FSPISH sqaron se nuk ka prekur asnjë prej parashikimeve të kësaj kontrate.

FSPISH theksoi gjithashtu faktin se shoqëria Kürüm International sh.a. akuzon haptazi dhe bën lojra fjalësh për një grevë të zhvilluar, ku sipas dokumentacionit dhe çdo lloj informacioni tjetër nuk ka patur grevë, por protestë. Kjo është e dokumentuar dhe me vazhdimësinë e punës në Hece. FSPISH sqaron gjithashtu se termi protestë konsiderohet, kur punonjësit bëjnë tubim paqësor pa ndërprerje të punës dhe prodhimit, ndërsa termi grevë do të thotë kur punonjësit ngujohen në vendet e punës dhe merren masa paraprake për zhvillimin e saj (njoftohet Kompania, spitali, policia e shtetit etj.), si dhe ndalohej puna dhe prodhimi. Në këtë kontekst, FSPISH sqaron se Kompania, po abuzon qëllimisht me termat.

Lidhur me informacionin e dhënë nga Kürüm International sh.a., në adresë të KMD-së, FSPISH sqaron se A. M nuk ka dijeni mbi masën disiplinore të datës 30.05.2015, por pohon se është thirrur nga Kompania dhe është vënë në dijeni të faktit që pretendohet nga Kompania për fallsifikim të dokumenteve shkollorë, i cili realisht konsiston në një keqkuptim dhe ngatërresë të bërë në dokumentacionin e tij shkollor.

Lidhur me pretendimet e Kompanisë së z. M ka braktisur vendin e punës, FSPISH sqaron se një gjë e tillë nuk është e vërtetë pasi si z. M, ashtu edhe z. R rezultojnë me raport mjekësor për ato ditë dhe pjesëmarrja e tyre në protestë nuk ka qenë e plotë. FSPISH sqaron gjithashtu se Kompania e quan protestën e tyre si “grevë e paligjshme”, ndërkohë që për paligjshmërinë e grevës, mund të shprehet vetëm gjykata. Lidhur me pretendimet e Kompanisë për punonjësin e Hecit Shkopet, M. N, nënkryetar

i Këshillit Sindikal të Heceve, i cili ka marrë masë disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, FSPISH sqaron se ankuesi nuk e ka shkelur kontratën e punës, pasi legjislacioni shqiptar lejon pjesëmarrjen në Sindikatë, sikurse mund të marrë pjesë në një protestë apo grevë të ligjshme të njohur nga gjykata. I njëjti arsyetim është përdorur edhe për A. R, i cili nuk ka qenë në shkelje të kontratës kolektive, si dhe në shkelje të Aktmarrëveshjes, pasi kjo e fundit është kundërshtuar nga ana e FSPISH dhe është refuzuar pas fazës së parë të saj. FSPISH kërkon nga Kompania fakte dhe prova konkrete të veprimeve në kundërshtim me ligjin dhe të bllokimit të aktivitetit të hidrocentraleve për shkak të kësaj proteste, sikurse pretendohet.

Lidhur me mosnjohjen e pretendimit që M. N është pezulluar pa afat nga detyra, FSPISH sqaron se kjo Shoqëri ka marrë një masë pezullimi për përfaqësuesit e Këshillit Sindikal, për shkak të pjesëmarrjes në protestë, ndërkohë që vetëm gjykata kompetente mund të vlerësojë nëse aksioni sindikal është i ligjshëm apo i paligjshëm. Vetëm nëse gjykata shprehet me një vendim, punëdhënësi ose e kthen në punë punëmarrësin ose e pushon atë në varësi të vendimit të marrë.

Në datën 14.06.2021, pas një mbledhjeje në Ulëz me Këshillin Sindikal të Heceve, Sindikata ka marrë vendim të pezullojë përkohësisht protestën e nisur në datën 26.05.2021, vendim, të cilin ia ka komunikuar zyrtarisht kompanisë Kürüm International sh.a.

Kompania i ka kthyer përgjigje Sindikatës nëpërmjet shkresës nr. 388 prot., datë 15.06.2021, duke e konsideruar sërish aksionin sindikal si “grevë” dhe jo “protestë”. Për më tepër citohet që *“pezullimi i të drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga marrëdhëniet e punës do të vazhdojnë deri në momentin e administrimit të vendimit tuaj përfundimtar për përfundimin e “grevës”*”.

Me anë të e-mailit të datës 16.06.2021, FSPISH i ka kthyer përgjigje Kompanisë rreth pretendimeve të padrejta dhe i ka kërkuar dhe një herë të rikthejë në punë drejtuesit e sindikatës dhe të vendosë ura komunikimi.

FSPISH përgënjeshtrojnë informacionin e dhënë nga Kompania, me arsyetimin se 5 (pesë) drejtuesit e Këshillit Sindikal deri më sot nuk janë lejuar nga kompania të shkojnë në vendet e tyre të punës, edhe pse Kürüm Internationa sh.a. shprehet në shkresën e saj, se masat ndaj tyre janë hequr. Këta persona vazhdojnë ende të jenë të pezulluar, pasi nuk lejohen të shkojnë në vendet e tyre të punës. Këta punonjës nuk kanë asnjë njoftim për heqjen e masës disiplinore dhe masës së pezullimit. Referuar listëpagesave të muajit qershor 2021, të paraqitura nga Kompania, ankuesit janë paguar 6 ditë duke i dhënë lejen e zakonshme, pa i vënë në dijeni për dhënien e saj, fakt që bie në kundërshtim me Kodin e Punës. Në listëpagesat e paraqitura nga kompania Kürüm International sh.a vihet re se janë 26 punonjës, ndërkohë që si përfaqësues të punonjësve dhe nënshkrues legjitim të kontratës së punës punojnë aktualisht 42 punonjës.

Në përfundim të informacionit, FSPISH thekson edhe një herë se tubimi ka qenë paqësor dhe pa ndërprerë procesin e punës dhe të prodhimit të energjisë elektrike.

- Në vijim, KMD i dërgoi për dijeni Kürüm International sh.a. një kopje të shkresës së sipërcituar të FSPISH.
- Nëpërmjet shkresës nr. 536 prot., datë 12.08.2021, kjo Shoqëri ka dërguar prapësimet e saj në adresë të KMD-së, ku sqaron që pretendimet e FSPISH nuk janë të bazuara dhe kërkojnë nga KMD që këto pretendime të mos merren parasysh pasi janë të paprovuara.

Në këtë shkresë theksohet fakti se të dy fazat e ristrukturimit janë të parashikuara në Akt marrëveshje, të cilat kanë të bëjnë me kohën e kryerjes së ristrukturimit, numrin e punonjësve të përfshirë, kriteret, arsimin etj. Në shkresë theksohet fakti se FSPISH nuk ka patur kundërshtime gjatë fazës së parë të ristrukturimit. Për shkak të respektimit rigoroz të kriterëve të Aktmarrëveshjes nga punëdhënësi kanë qendruar në punë drejtuesit e sindikatës, V. R i cili mbush moshën për pension pleqërie si dhe M. N, pozicioni i së cilit është shkurtuar me ristrukturim. Kompania thekson faktin se vetë FSPISH ka deklaruar se në rastin konkret bëhet fjalë për grevë, porse tashmë ka ndryshuar terminologji duke e quajtur “protestë”. Fakti se aktualisht FSPISH nuk i intereson më Aktmarrëveshja e lidhur me shoqërinë, nuk është problem i Kürüm International sh.a., pasi kjo Aktmarrëveshje është një akt i ligjshëm. Kürüm, rikthekson faktin se çështja lidhur me grevën e paligjshme është duke u gjykuar gjyqësisht pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Kürüm sh.a. thekson edhe një herë faktin se me marrjen e njoftimit, për pushimin e grevës, të katër përfaqësuesit e Këshillit Sindikal vazhdojnë të jenë në marrëdhënie pune.

- Në vijim të procedurave hetimore, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u vendos u zhvillua në datën 20.10.2021, ora 10:00, pranë Zyrës së KMD-së. Në këtë seancë dëgjimore, morën pjesë përfaqësuesit e Kürüm International sh.a. dhe përfaqësues të FSPISH.

Në këtë seancë dëgjimore përfaqësuesit e FSPISH parashtruan edhe një herë pretendimet e tyre për diskriminim për shkak të “përkatësisë në një grup të veçantë “ të të tre ankuesve. Z. K u shpreh se në vitet e para, pas nënshkrimit të kontratës kolektive të punës, ndërmjet FSPISH dhe Kürüm International sh.a., kanë ekzistuar marrëdhënie mjaft të mira dhe bashkëpunuese, fakt që është reflektuar sidomos në mbështetjen që FSPISH i ka dhënë kësaj shoqërie në ndërmarrjen e reformave të saj. Ndërkohë që, konfliktet kanë lidhur përgjatë reformës së fundit që ka ndërmarrë kjo kompani. Problematikat janë shfaqur në marrëdhëniet e GJ. M., Drejtor i Burimeve Njerëzore pranë kësaj Shoqërie dhe Sindikatës. I pyetur nëse shtohet numri i subjekteve kundër së cilit drejtohet pretendimi për diskriminim, përfaqësuesi ligjor i Kurum International sh.a. u shpreh që subjekt është vetëm Shoqëria.

Përfaqësuesi ligjor i Sindikatës u shpreh se Kurum International sh.a. ka diskriminuar për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë, punonjësit: M. N me detyrë personel turni dhe Nënkyetar i Këshillit Sindikal, A. M, me detyrë Përgjegjës i Zyrës Mekanike dhe anëtar i Këshillit Sindikal dhe A. R me detyrë mekanik remonti që mban pozicionin e anëtarit të Këshillit Sindikal të FSPISH.

Përfaqësuesi ligjor sqaroi se, fillesa e protestës së FSPISH ka qenë refoma e fundit e ndërmarrë nga Shoqëria, pasi ka kryer rinovim tërësor të impianteve në hidrocentrale, ku automatizimi i proceseve

të punës, passolli shkurtimin e fuqisë punëtore. Kurum International sh.a. kishte detyrim të njoftonte FSPISH mbi kriteret e ndjekura për punonjësit që do t'i nënshtrohen ristrukturimit, numrin dhe emrat e punonjësve, afatet përgjatë së cilit do të shtrihet ristrukturimi, personat përgjegjës brenda Kurum International që do të merreshin me procesin ristrukturues etj, gjë që nuk e ka kryer. Pavarësisht kësaj, FSPISH nënshkroi një Akt Marrëveshje me Shoqërinë në shkurt të vitit 2020, lidhur me zbatimin e ristrukturimit. Gjatë fazës së parë të zbatimit të Aktmarrëveshjes u kryen shkelje të ndryshme nga ana e Kurum International sh.a. Këshilli Sindikal ia vuri në dukje këto shkelje dhe Shoqëria sqaroi se do të rregulloheshin në fazën e dytë të Akt Marrëveshjes. Ndërkohë që, ndodhi e kundërta, pasi Shoqëria vazhdoi thellimin e shkeljeve të saj në procesin e ristrukturimit.

Pavarësisht shkresave të dërguara nga FSPISH, Shoqëria ka dërguar përgjigje se ishte në zbatim të Aktmarrëveshjes. FSPISH nuk ishte kundër ristrukturimit, por Kurum sh.a. duhet të merrte edhe mendimin e kësaj Sindikate. Në bazë të Aktmarrëveshjes janë përcaktuar një sërë kriteresh për përjashtimin e disa kategorive punonjësish nga ristrukturimi, parashikim ky që nuk është respektuar nga Kurum International sh.a. Në këtë kontekst, Kurum International ka shkelur nenin 11 të Kodit të Punës, që parashikon parimin e mirëbesimit.

FSPISH i dërgoi një shkresë Kurum International sh.a., sipas së cilës anulonte Aktmarrëveshjen, e cila sipas FSPISH ishte shkelur nga Kurum International sh.a. gjatë procesit të ristrukturimit.

Në këto kushte, FSPISH vendosi të organizonte një protestë apo tubim paqësor para godinës së Shoqërisë, të cilën Kurum International sh.a. e quan grevë dhe për këtë arsye çështja në fjalë është duke u shqyrtuar gjyqësisht. Përfaqësuesi ligjor i Sindikatës u shpreh se punonjësit e Shoqërisë që morën pjesë në këtë protestë ishin jashtë orarit të punës dhe në asnjë rast nuk është cënuar mbarëvajtja e punës së Shoqërisë.

Në emër të Akt-Marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet FSPISH dhe Kurum International sh.a., kjo e fundit mori disa masa disiplinore ndaj disa punonjësve të tij, që ishin njëkohësisht edhe anëtarë të Sindikatës, pasi këta të fundit kishin qenë pjesë e protestës së zhvilluar para godinës së FSPISH. Kështu:

Për A. M u dha masa disiplinore është dhënë vërejtje me paralajmërim për largim nga puna dhe ulje në detyrë për 6 muaj, me motivacion se ka braktisur vendin e punës etj. pasi ka marrë pjesë në grevë.

Për A. R u dha vërejtje me paralajmërim për largim nga puna.

Për M. N u dha vërejtje me paralajmërim për largim nga puna, me të njëjtin motivacion. Njëkohësisht të tre punonjësit janë pezulluar deri në përfundim të protestës. Gjatë pezullimit ata janë paguar me 50% të pagës. M. N u shpreh se pezullimi ka qenë për sa kohë do të vazhdonte protesta, por ata edhe nuk shkonin në punë.

FSPISH e ka njoftuar zyrtarisht Shoqërinë që protesta ka përfunduar. T. K u shpreh se protesta zgjaste nga ora 10:00 deri në orën 12:00 e paradites dhe në të merrnin pjesë ata punonjës që kishin përfunduar turnin e tyre. M. N u shpreh se ka dalë në protestë ditët e pushimit dhe se nuk e ka shkelur orarin e punës. Përfaqësuesi ligjor i FSPISH u shpreh se A. R dhe A. M kanë qenë me raport mjekësor në ditët e protestës, por këto raporte nuk u janë njohur nga ana e shoqërisë. Të pyetur se, ku i kanë paraqitur raportet e tyre, ata u shprehen se i kanë paraqitur siç paraqiten zakonisht. A. M u shpreh se ka punuar për 22 vjet në repartin Ulëz-Shkopet. Ai u shpreh se ka dalë në protestë, por në datën 26 -28 maj 2021 ka qenë me raport paaftësie të përkohshme në punë. I pyetur se ku e ka dorëzuar këtë raport, ai u shpreh se raporti nuk është dorëzuar tek punëdhënësi, pasi nuk e kanë lejuar të futet në ambientet e punës. I pyetur nëse ia ka bërë të ditur punëdhënësit në ndonjë mënyrë tjetër raportin e sipërcituar, A. M u shpreh se nuk ka përdorur mënyra të tjera (e-mail apo mesazhe), por raportin për paaftësi të përkohshme në punë e ka dorëzuar pranë z. K. Edhe z. R ka qenë me raport për paaftësitë të përkohshme në punë në të njëjtat data, por as ai nuk ka patur mundësi ta dorëzojë raportin mjekësor, i cili u shpreh se në datën 26 maj 2021 ka hyrë në punë dhe i ka thënë punonjësës D.Q. se është me raport për paaftësi të përkohshme në punë. Ai u shpreh se në ndryshim me kolegun e tij, atij ia kanë pranuar raportin shëndetësor, ndërkohë që pas ditëve të raportit, ai nuk është lejuar të ketë akses në punë.

Përfaqësuesit e Kurum International sh.a. sqaruan se asnjë nga pretendimet e të tre ankuesve nuk qëndrojnë dhe se në deklaratimet e tyre të fundit ka fakte të pavërteta. Juristja e kësaj shoqërie, V. K, u shpreh se ndërmjet FSPISH dhe Kurum International sh.a. është nënshkruar një kontratë kolektive 3-vjeçare, e cila është ende në fuqi. Mbështetur në këtë akt janë respektuar të gjithë parashikimet për punonjësit e Shoqërisë.

Ajo u shpreh se së fundmi, Shoqëria ka ndërmarrë një proces ristrukturimi pozicionesh pune, si pasojë e automatizimit të proceseve të punës, në Hecet Ulëz-Shkopet. Në këtë kontekst, kanë rezultuar të panevojshëm mekaniku i turnit dhe remontierit mekanik. Në këto kushte, kur këto pozicione pune dolën si të panevojshme, Administratori i Shoqërisë vlerësoi një ristrukturim të fuqisë punëtore. Në këtë kuadër FSPISH dhe shoqëria Kurum International sh. a kanë lidhur një Akt-Marrëveshje ndërmjet tyre. FSPISH pretendon se nuk ka patur të dhëna të sakta mbi numrin e punonjësve, ndërkohë që V. K e kundërshtoi në fakt të tillë duke theksuar faktin se kanë qenë të mirëpërcaktuar numri i punonjësve dhe pozicionet e tyre të punës që do t'i nënshtroheshin ristrukturimit, Kurum International sh.a. ka përcaktuar saktësisht të dy elementët e sipërcituar.

Pas përcaktimeve të sipërcituara, palët kanë lidhur një Akt-Marrëveshje. Ristrukturimi është menduar që të zgjatet në kohë përgjatë viteve 2020 dhe 2021, ku përfshihen dy faza. Në vijim ka filluar faza e parë e procesit të riorganizimit, për të cilën, FSPISH nuk ka patur asnjë kontestim. Në momentin që u fillua faza e dytë dhe filluan njoftimet e punonjësve për suprimim të pozicioneve të punës, FSPISH kundërshtoi duke filluar një grevë të paligjshme kundër Kurum International sh.a. V. K theksoi faktin se janë zbatuar me përpikmëri të gjitha parashikimet e Akt-Marrëveshjes për sa i përket numrit të punonjësve, kriterit arsimor, pozicionit të tyre të punës, si dhe kriterit e të qenit në

organet drejtuese sindikale të FSPISH. Ndaj punonjësve që i janë nënshtruar ristrukturimit janë zbatuar të gjitha parashikimet e Kodit të Punës.

Greva e paligjshme e FSPISH bie në kundërshtim me kontratën kolektive të punës të nënshkruar nga të dy palët dhe përkatësisht parashikimin mbi paqen kolektive. Aktmarrëveshja e nënshkruar ndërmjet palëve është akti që përcaktonte dakordësinë e FSPISH mbi procesin ristrukturues që do të zbatonte Kurum International sh.a. Kjo është një marrëveshje e rregullt dhe e nënshkruar dhe protokolluar nga palët. Përfaqësuesja e Kurum International vuri theksin se përveç grevës së paligjshme, për të cilën Shoqëria i është drejtuar gjykatës, T. K me detyre Sekretar i Përgjithshëm i FSPISH dhe A. M kanë bërë deklarata publike në media⁶ se do të bllokojnë turbinat dhe do të hapin portat e shkarkimit të ujrave të hidrocentraleve. Këto deklarime kanë përmbajtje të rrezikshme. Njëkohësisht, ajo shprehet se veprimi i bllokimit të postëbllokut dhe moslejimi i hyrjes së i drejtorit të Hecit të Ulzës si dhe i drejtuesve të Kompanisë është një veprim i rrezikshëm dhe ka patur pasoja në veprimtarinë e shoqërisë.

Ajo shtoi gjithashtu se kanë qenë anëtarët e sindikatës që kanë bllokuar hyrjen për në Shoqëri dhe jo anasjelltas. Ata kanë penguar hyrjen e përfaqësuesve të Shoqërisë dhe kanë deklaruar se do të shtrihen para automjetit të tyre për të mos lejuar aksesin e titullarëve të Shoqërisë në godinë. Përfaqësuesja e Kurum International sh.a. shprehet se A. M dhe A. R rezultojnë të jenë pjesëmarrës në grevë në datën 26.05.2021, ndërkohë që pretendojnë se kanë qenë me raport paaftësie të përkohshme. Kjo vërtetohet me fotot përkatëse. Ajo shtoi se të tre ankuesit nuk janë përfshirë në shkurtimin e fuqisë punëtore, edhe pse nuk i plotësonin kriteret e arsimit, kualifikimeve etj, pasi në bazë të Aktmarrëveshjes së lidhur, drejtuesit dhe anëtarët e Këshillit Sindikal nuk do t'i nënshtroheshin ristrukturimit të fuqisë punëtore, megjithëse nuk i plotësonin kriteret arsimore dhe ato të kualifikimit.

Pozicioni i punës së M. N, mekanik turni, është suprimuar, por ai është sistemuar në detyrë tjetër “personel ndihmës”. A. M, mekanik remonti është parashikuar në qendrojë në punë edhe pse nuk ka arsimin e duhur (arsim të mesëm bujqësor) dhe ndaj tij është dhënë një masë disiplinore paraprake (2015) për fallsifikim dokumentacioni. Ai ka deklaruar se është me shkollë të mesme ndërkohë që nuk e ka kryer arsimin e mesëm. Falë ndërhyrjes së FSPISH, Shoqëria e ka mbajtur në punë. Edhe z. R nuk e plotëson kriterin arsimor, por pavarësisht kësaj është mbajtur në punë nga shoqëria. Z. M dhe z. K ka publikuar se do të hyjnë në grëvë urie dhe do të hapim portat e heceve që uji të shkojë në det⁷.

Referuar deklaratave të bëra, si dhe veprimeve të paligjshme të ndërmarra (pjesëmarrja në grevë të paligjshme), punëdhënësi ka gjykuar se deri në momentin që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan do të shprehet mbi ligjshmërinë e grevës në të cilën ata kanë marrë pjesë, si dhe mbështetur në deklaratat e bëra nga drejtuesit e FSPISH dhe anëtarët e Këshillit Drejtues, se ata mund të përbënin rrezik për mbarëvajtjen e punës, Shoqëria i ka pezulluar deri në momentin e ndërprerjes së grevës,

⁶ Youtube_fax news

⁷ Referuar youtube_fax news të datës 22.05.2021

por duke i paguar me pagën bazë (100%) të pozicioneve përkatëse të punës. Dhënia e masave disiplinore ka patur si motivacion pjesëmarrjen në një grevë të paligjshme (në bindjen e punëdhënësit), si dhe dhënien e deklaratave me përmbajtje të rrezikshme.

Përfaqësuesit e KMD-së kërkuar procedurat e ndjekura për dhënien e masave disiplinore. Ndërkohë që, dy ankuesit e tjerë kanë masa disiplinore pa patur pezullim. Përfaqësuesi tjetër i Kurum sh.a. u shpreh se z. N ishte më agresivi dhe ndaj tij u mor masa për pezullim, ndërkohë që personat e tjerë nuk kanë qenë në punë se kanë marrë pjesë në grevë. Ai theksoi faktin se vërejtja “Paralajmërim për largim nga puna” është dhënë pasi ata kanë marrë pjesë në një grevë të paligjshme, fakt ky që po gjykohet gjyqësisht. Për z. M, vendimi për vërejtje është dhënë në 23 maj 2021, pasi ka braktisur vendin e punës dhe nuk ka marrë leje nga eprorët. Z. M i janë dërguar njoftimet përkatëse zyrtare dhe ai ka dërguar kundërshtimet e tij për sa më sipër. Përfaqësuesit e KMD-së pyetën nëse ankuesit janë bërë me dije lidhur me masën që do të merrej dhe ç’praktikë është ndjekur nga Kurum sh.a. për dhënien e kësaj mase. Këtu ai e pohon se ka marrë pjesë në protestë.

Përfaqësuesi ligjor i FSPISH shprehet se Kurum sh.a. i ka dhënë masat pasi pretendon se greva në të cilën kanë marrë pjesë ankuesit është e paligjshme dhe se është shkelur parimi i paqes absolute, e parashikuar në kontratën kolektive të punës, ndërkohë që FSPISH nuk ka organizuar një grevë, por thjesht një protestë paqësore, në ambientet e jashtme të punës. Protesta është bërë gjatë orarit të punës 10:00-12:00, por pjesëmarrësit në grevë nuk kanë lënë punën. Lidhur me raportet mjekësore, ai sqaron se nuk është dakord me përfaqësuesit e Kurum International sh.a. të cilët deklarojnë se për sa kohë, dy prej ankuesve kanë qenë me raport paaftësie të përkohshme në punë, ata duhet domosdoshmërisht të rrinë në shtrat në shtëpi dhe jo të marrin pjesë në grevë, pasi është në vlerësimin e tyre nëse duhet të marrin pjesë në protestë apo të rrinë në shtëpi.

Përfaqësuesit e Kurum International sh.a. u pyetën nga përfaqësuesit e KMD-së nëse ka punonjës të tjerë të Shoqërisë që kanë marrë pjesë në grevë, të cilët nuk janë anëtarë të Keshillit Sindikal apo drejtues të FSPISH por ndaj tyre janë marrë masa disiplinore të njëjtat apo të ngjashme me ankuesit.

Përfaqësuesja e Kurum u shpreh se organizatorët e grevës kishin interesa personale dhe jo kolektive në zhvillimin e saj. Kështu, M. N ishte pjesëmarrës në grevë pasi bashkëshortja e tij ishte në listat e shkurtimeve të Shoqërisë. Punonjësit e tjerë të Shoqërisë nuk e përkrahën FSPISH në grevë dhe ishin familjarët e organizatorëve të grevës, të cilët ishin pjesëmarrës në të. Organizatorët e grevës kanë abuzuar me statusin e tyre sindikal si të paprekshëm dhe ishin të vetmit punonjës të heceve që morën pjesë në grevë bashkë me familjarët e tyre, si dhe punonjës të përfshirë në reformë. Nga 43 punonjës të heceve Ulëz Shkopet, vetëm ankuesit ishin pjesëmarrës në grevë.

Lidhur me dy ankuesit që nuk është marrë masë disiplinore, përfaqësuesit e Kurum sh.a., sqaruan se ata nuk janë pranuar në punë për arsye sigurie, pasi pas deklaratave të bëra në media ekzistonte frika e sabotazhit nga ana e tyre në hece. Të pyetur gjithashtu nëse ekzistonte një akt i brendshëm i Shoqërisë, ku është materializuar fakti i deklaratave të dhëna në media, nga ana e anëtarëve të Keshillit Sindikal, të cilat kishin përmbajtje të rrezikshme, përfaqësuesit e Kurum sh.a. u shprehën se fakte të tilla janë bërë të ditura me anë të e-maileve ndërmjet strukturave të Shoqërisë lidhur me deklaratat përkatëse.

Përfaqësuesit e Kurum u shprehen se të tre ankuesit janë paguar me pagën bazë, e cila është e njëjtë me pagën e marrë kur ata kanë qenë në punë. Në këtë pagë nuk përfshihet vetëm vlera në lekë e vakteve ushqimore, që ata konsumojnë në ambientet e Shoqërisë, për sa kohë ata nuk kanë qenë në punë.

Përfaqësuesit e KMD-së u parashtruan palëve mundësinë e zgjidhjes së çështjes me ndërmjetësim. FSPISH kërkoi të vazhdojë normaliteti mes palëve, si dhe ankuesit të kthehen në punë, t'u jepet diferenca në pagë dhe t'u hiqet masa disiplinore.

Gjatë seancës dhe në vijim, përfaqësuesit e Kürüm International sh.a. vunë në dukje fakti se mbi çështjen e paligjshmërisë së grevës së kryer nga punonjësit që janë në cilësinë e ankuesit, duhet që së pari të shprehej me vendim të formës së prerë gjykata respektive, pasi masat disiplinore janë dhënë për pjesëmarrje në grevë të paligjshme.

- Për sa më sipër, KMD konstatoi se referuar dokumentacionit të dërguar nga Kürüm International sh.a. dhe përkatësisht aktit Vërtetim nr. 034958004, datë 23.06.2021, të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan rezultonte se në datën 03.06.2021, pranë kësaj gjykate është depozituar kërkesëpadia me palë paditëse - Kürüm International sh.a., palë të paditur - Federata Sindikale e Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë dhe objekt – deklarin e grevës së datës 26.05.2021, si të paligjshme.

Referuar Vërtetimit të sipërcituar, çështja civile është e regjistruar me Nr. 816 (04660), datë 03.06.2021.

Në kushtet kur, çështja objekt ankese pranë KMD-së, kishte lidhje të drejtpërdrejtë me vendimmarrjen e gjykatës mbi ligjshmërinë e grevës, në të cilën kanë marrë pjesë punonjësit ankues të Kürüm International sh.a. dhe si pasojë e kësaj pjesëmarrje, ndaj tyre janë marrë masa disiplinore dhe janë pezulluar nga puna, mbështetur në nenin 85, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative, ku përcaktohet se: *“3. Në ato raste kur informacioni apo dokumentet e kërkuara nga palët janë të domosdoshme për shqyrtimin e pretendimit të ngritur nga vetë palët, procedura pezullohet deri në sigurimin e informacionit dhe palët njoftohen për këtë gjë”*, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi çmoi se procedurat për shqyrtimin e ankesës duhet të pezulloheshin, deri në momentin, kur palët do të depozitonin në cilësi prove vendimin gjyqësor, lidhur me çështjen objekt gjykimi.

Për sa më sipër, KMD u shpreh me vendimin nr. 7, datë 10.01.2022, nëpërmjet së cilit pezulloi procedurat për shqyrtimin e ankesës, deri në momentin që gjykata do të shprehej me vendim lidhur me çështjen e ligjshmërisë së grevës.

- Në vijim, Kürüm International sh.a. e njoftoi KMD me e-mailin e datës 28.10.2022, se Gjykata e Apelit Durrës është shprehur me vendimin nr. 10-2022-1124 (308), datë 06.07.2022, nëpërmjet së cilit ka lënë në fuqi vendimin nr. 165, datë 28.02.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, ku greva e FSPISH është shpallur e paligjshme.

- Në këto kushte, KMD u shpreh me vendimin nr. 199, datë 03.11.2022, *“Për ndërprerje të pezullimit dhe çelje të procedurave për shqyrtimin e ankesës“*, nëpërmjet së cilës rifilloi shqyrtimin e ankesës nr. 121/2021.
- Në vijim të procedurave hetimore, për efekt të shqyrtimit të ankesës, KMD mbajti korrespondencë me e-maile me përfaqësuesit e Kürüm International sh.a., si dhe me shkresa zyrtare. Në këtë kontekst, KMD iu drejtua Kürüm International sh.a. nëpërmjet shkresës nr. 1243/8, datë 17.11.2022⁸, ku kërkohej informacioni i mëposhtëm:
 1. Informacion mbi statusin aktual të M. N dhe A. R, nëse ata vazhdojnë ende të jenë të pezulluar, apo nëse ata kanë rifilluar punë pranë kësaj Shoqërie.
 2. Nëse punonjësit e sipërcituar kanë filluar punë, lutemi të dërgohet akti administrativ i njehsuar me origjinalin, nëpërmjet së cilit, Kürüm International ka ndërprerë pezullimin e tyre, si dhe kopje të njehsuara me origjinalet të listëpagesave të Kürüm International sh.a., ku reflektohet statusi dhe paga e punonjësve të sipërcituar nga momenti i zhvillimit të seancës dëgjimore pranë KMD-së e në vijim.
 3. Nëse pezullimi ndaj këtyre punonjësve është ende në fuqi, të bëhet me dije Komisioneri mbi veprimet që Kürüm International sh.a. do të ndërmarrë në vijim, lidhur me këta punonjës.
 4. Kopje e njehsuar me origjinalin e kërkesës për dorëheqje të A. M dhe akti i lirimit të tij nga detyra.
- Në përgjigje të shkresës nr.1243/8, datë 17.11.2022, të KMD-së, Kürüm International sh.a. u përgjigj me shkresën nr. 853 prot, datë 30.11.2022, ku sqaron se marrëdhënia juridike e punës së shoqërisë me A. R dhe M. N vazhdon dhe ata vazhdojnë të marrin pagesat përkatëse për çdo muaj sipas pozicionit të tyre të punës, që prej datës së përfundimit të grevës, e cila është 22.06.2021, si të gjithë punonjësit e tjerë të Shoqërisë.

Për sa më sipër, Kürüm International sh.a. sqaron se në kushtet kur greva e paligjshme kishte filluar, me vendimin nr. 365 prot., datë 04.06.2021, në zbatim të nenit 197/8 të Kodit të Punës, Shoqëria ka vendosur *“Pezullimin e të drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga marrëdhënia e punës“* (ku përfshihet edhe e drejta e pagës dhe detyrimi i bindjes në punë sipas nenit 197/8 të Kodit të Punës), pezullim, i cili ka vazhduar deri në datën 22.06.2021, datë në të cilën Këshilli Sindikal i Federatës Sindikale të Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë njoftoi shoqërinë Kürüm International sh.a. për përfundimin e grevës. Pra, vendimi nr. 365 prot., datë 04.06.2021, i cili nuk ka qenë një masë disiplinore, pasi një pezullim të tillë e sanksionon drejtpërdrejt neni 197/8 i Kodit të Punës, mbi të gjitha e ka përcaktuar qartë në përmbajtje kohëzgjatjen e efekteve të tij dhe konkretisht në pikën 2

⁸ Shkresa e sipërcituar iu dërgua për dijëni edhe FSPISH.

dhe 4 të tij, si më poshtë: “2. *Ky pezullim do të vazhdojë për aq kohë sa do të vazhdojë të ushtrohet greva*“ dhe “4...*vendimi është i përkohshëm dhe zgjat deri në përfundimin e grevës*“.

Me njoftimin e marrë në datën 22.06.2021 nga Këshilli Sindikal i FSPISH për përfundimin e grevës, automatikisht edhe vendimi nr. 365 prot., datë 04.06.2021, i ka përfunduar efektet, pra nga data 22.06.2021 e më pas nuk ka më efekt dhe nuk është më në fuqi. Për rrjedhojë edhe pezullimi i vendosur me anë të këtij vendimi ka rënë dhe nuk mund të jetë në fuqi. Kjo gjë është provuar me listëpagesat për periudhën maj 2021-qershor 2021, të cilat Shoqëria ia ka vënë në dispozicion KMD-së gjatë seancës dëgjimore. Pra, pas përfundimit të grevës, punësimi i tyre ka vazhduar dhe ata kanë përfutur pagesat mujore përkatëse (për çdo muaj) sipas pozicionit të punës që prej datës 22.06.2021 e në vijim si të gjithë punonjësit e tjerë të shoqërisë. Njëkohësisht, Kürüm International sh.a. njofton se bashkëlidhur shkresës gjenden listëpagesat për periudhën tetor 2021-tetor 2022, të gjeneruara nga sistemi tatimor. Këtu sqarohet se listëpagesa e muajit nëntor 2022 gjenerohet nga sistemi tatimor në muajin dhjetor 2022 (20.12.2022) dhe në momentin e gjenerimit nga sistemi on line tatimor, Shoqëria do t'ia vërë në dispozicion KMD-së. Në zbatim të ligjit nr. 107/2021, datë 04.11.2021, këto akte janë marrë nga platforma e-Albania shoqëruar me vulë digjitale.

Ndërkohë që, Kürüm International sh.a. sqaron në vijim se A. M ka depozituar kërkesë për dorëheqje nga puna, për arsye familjare, në datën 29.03.2022. Kjo kërkesë është miratuar nga Shoqërisë, fakt që pasqyrohet në aktin “Marrëveshja për zgjidhjen me vullnetin e tyre të kontratës së punës“ nr. 256 prot., datë 29.03.2022, nënshkruar ndërmjet Kürüm International sh.a. dhe A. M. Më pas, A. M, me anë të Deklaratës Noteriale nr. 256 Prot., Nr. Kol. 663, datë 29.03.2022 deklaroi se me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë se është dakord tërësisht me aktin “Marrëveshja për zgjidhjen me vullnetin e tyre të kontratës së punës“ nr. 256 prot., datë 29.03.2022 dhe se e ka zgjidhur me mirëkuptim kontratën e tij të punës. Me anë të kësaj deklarate, por edhe me anë të kontratës së sipërcituar, A. M deklaroi se heq dorë në mënyrë të vullnetshme nga çdo pretendim në lidhje me punësimin dhe/ose të drejtat e tjera ndaj Kürüm International sh.a. Mbështetur në legjislacionin në fuqi, largimi i tij nga puna nëpërmjet dorëheqjes është pasqyruar edhe në organet tatimore në dokumentin E-sig.

Bashkëlidhur shkresës së Kürüm International sh.a. është paraqitur edhe dokumentacioni i kërkuar nga KMD mbi këtë çështje

I. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Trajtimi i padrejtë, disfavorizues dhe i pabarabartë i ankuesve.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, vlerësimi e analizimi i tyre, Komisioneri vlerëson se:

Subjektet ankues: M. N, i cili është Nënkryetar i Këshillit Sindikal të Heceve Ulëz-Shkopet, A. M, i cili mban pozicionin e Sekretarit të Këshillit dhe A. R, i cili mban pozicionin e anëtarit të Këshillit,

janë përfaqësuar para Komisionerit nga Federata e Sindikatave të Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë.

Ankuesit janë në marrëdhënie pune me shoqërinë Kürüm International sh. a dhe kanë pretenduar se janë diskriminuar nga punëdhënësi, pasi ai ka ndërmarrë “sanksione” ndaj tyre si drejtues dhe anëtarëve të FSPISH, gjatë marrëdhënieve të punës, duke u dhënë masa disiplinore dhe duke i pezulluar pa afat nga detyra, nën pretekstin e pjesëmarrjes në greva të paligjshme.

Komisioneri vëren se, njëri nga ankuesit, A. M, në datën 29.03.2022, ka depozituar pranë shoqërisë Kürüm International sh.a kërkesën për dorëheqje nga puna, për arsye familjare.

A. M, me anë të Deklaratës Noteriale nr. 256 Prot., Nr. Kol. 663, datë 29.03.2022 deklaroi se me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë se është dakord tërësisht me aktin “Marrëveshja për zgjidhjen me vullnetin e tyre të kontratës së punës“ nr. 256 prot., datë 29.03.2022 dhe se e ka zgjidhur me mirëkuptim kontratën e tij të punës.

Me anë të kësaj deklarate dhe të kontratës së sipërcituar, A. M deklaroi se heq dorë në mënyrë të vullnetshme nga çdo pretendim në lidhje me punësimin dhe/ose të drejtat e tjera ndaj Kürüm International sh.a.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet përfundimi i procedurës administrative: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Njëkohësisht, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaroi përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”, Komisioneri deklaroi përfundimin e shqyrtimit të pretendimeve të subjektit ankues A. M kundrejt punëdhënësit, pa një vendim përfundimtar, për shkak të heqjes dorë në mënyrë të vullnetshme nga ana e tij ndaj çdo pretendimi në lidhje me punësimin dhe/ose të drejtat e tjera ndaj Kürüm International sh.a.

Lidhur me vijimësinë e marrëdhënieve të punës me dy ankuesit / punonjësit e tjerë: A. R dhe M. N, nëpërmjet shkresës nr. 853 prot, datë 30.11.2022, të Shoqërisë, evidentohet fakti se, të dy ata vazhdojnë të marrin pagesat përkatëse për çdo muaj sipas pozicionit të tyre të punës, që prej datës së përfundimit të grevës, e cila është 22.06.2021, e në vijim, si të gjithë punonjësit e tjerë të Shoqërisë.

Pretendimet e ankuesve kundrejt Kompanisë për trajtim të padrejtë e të pafavorshëm për shkak të përkatësisë së tyre sindikale, lidhen me momentin e dhënies të masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, me datë 29.05.2021, për shkak se ata kanë marrë pjesë në një grevë të paligjshme, fakt i cili është gjykuar gjyqësisht.

Në një kronologji kohore, të ngjarjeve, fakteve e provave, evidentohet se:

- Punonjësit M. N dhe A. R rezultojnë të jenë pjesëmarrës në grevën e datës 26.05.2021, organizuar nga FSPISH.
- Për të dy ankuesit M. N dhe A. R, masat disiplinore “*Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna*”, dhe pezullimi i përkohshëm i tyre në punë, janë dhënë me datë 29.05.2021, pikërisht për shkak të pjesëmarrjes në këtë grevë, e cila nga ana e punëdhënësit është konsideruar e paligjshme.
 - Referuar aktit Vërtetim nr. 034958004, datë 23.06.2021, të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan rezulton se me datë 03.06.2021, pranë kësaj Gjykate është depozituar kërkesëpadi me palë paditëse - Kürüm International sh.a., palë të paditur - Federata Sindikale e Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë dhe objekt – deklarin e grevës së datës 26.05.2021, si të paligjshme.
 - Referuar Vërtetimit të sipërcituar, çështja civile është e regjistruar me Nr. 816 (04660), datë 03.06.2021.
 - Nisur nga vlerësimi se çështja objekt ankese pranë KMD-së, kishte lidhje të drejtpërdrejtë me vendimmarrjen e Gjykatës mbi ligjshmërinë e grevës, në të cilën kanë marrë pjesë dy ankuesit, dhe si pasojë e kësaj pjesëmarrje, ndaj tyre janë marrë masa disiplinore dhe janë pezulluar nga puna; me vendimin nr. 7, datë 10.01.2022, Komisioneri pezulloi procedurat për shqyrtimin e ankesës, deri në momentin që gjykata do të shprehej me vendim lidhur me çështjen e ligjshmërisë së grevës.
 - Lidhur me sa më sipër, Gjykata e Apelit Durrës është shprehur me vendimin nr. 10-2022-1124 (308), datë 06.07.2022, vendim i cili është vendim i formës së prerë.
 - Në këto kushte, KMD me vendimin nr. 199, datë 03.11.2022, “*Për ndërprerje të pezullimit dhe çelje të procedurave për shqyrtimin e ankesës*“, ndërpreu pezullimin dhe rifilloi shqyrtimin e ankesës nr. 121 Regj./2021.

Bazuar në vendimet gjyqësore, respektivisht: Vendimin nr. 165, datë 28.02.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe Vendimin nr. 308, datë 06.07.2022 të Gjykatës së Apelit Durrës⁹, rezulton se pretendimi i FSPISH lidhur me ligjshmërinë e grevës si pasojë e pjesëmarrjes në të cilën ndaj ankuesve ishin dhenë dhe masat disiplinore respektive nga Kürüm International sh.a., është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me të ka një vendim gjyqësor, i cili është i formës së prerë dhe i detyrueshëm për ekzekutim.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut/GJEDNJ, në jurisprudencën e saj ka sanksionuar se ekzekutimi i një vendimi të formës së prerë¹⁰ dhënë nga ndonjë gjykatë duhet të konsiderohet si një pjesë integrale e “gjykimit” për qëllime të Nenit 6 të Konventës (shih Hornsby k. Greqisë, 19 Mars 1997).

Në rrethanat kur jemi para një vendimi të formës së prerë, i cili është i detyrueshëm për zbatim, si dhe në kushtet kur çështja e pretendimeve të ankuesve për paligjshmëri të veprimeve të

⁹ Komunikuar Komisionerit me datë 28.10.2022.

¹⁰ Sanksionuar edhe në legjisllacionin e brendshëm kombëtar, në Kodin e Procedurës Civile.

punëdhënësit ndaj tyre, si rezultat i pjesëmarrjes në grevën e oragnizuar nga FSPISH, është shqyrtuar dhe zgjidhur gjyqësisht; Komisioneri, merr të mirëqenë konstatimet e bëra nga Gjykata dhe vendimin e saj të formës së prerë.

Në këto kushte, bazuar në sa më sipër, citojmë se Gjykata e Apelit Durrës, *inter alia*, në vendimin e saj, është shprehur se:

“Në lidhje me pretendimin e palës së paditur se jemi para një aksioni/proteste sindikale dhe jo greve, Gjykata e Apelit arsyeton si më poshtë:

“Në literaturën juridike përcaktohet se me termin grevë kuptohet: “ndërprerje e organizuar e punës nga ana e të punësuarve me qëllim të realizimit të të drejtave dhe interesave ekonomike, sociale dhe profesionale nga marrëdhënia e punës.”

Në analizë të këtij përkufizimi dalin në pah dy elementë thelbësore që një “protestë” të konsiderohet grevë:

1. Ndërprerja e organizuar e punës nga ana e punonjësve;

2. Me qëllim realizimin e kërkesave që vijnë nga marrëdhënia e punës.

Duke ju rikthyer çështjes objekt gjykimi, Gjykata e Apelit gjen të drejtë konkluzionin e GJykatës së Shkallës së Parë Elbasan se, jemi para një greve dhe jo një aksioni sindikal sikurse e quan pala e paditur. Rezulton nga aktet e ndodhura në dosje se, me datë 26.05.2021, punonjësit kanë ndërprerë punën në mënyrë të organizuar, madje nga ana e palës paditëse janë marrë edhe masa disiplinore për këtë shkak, provuar me aktet në dosjen gjyqësore. Gjithashtu, kjo ndërprerje e punës ka pasur si qëllim realizimin e kërkesave që kanë të bëjnë me kontratën kolektive të punës. Pra si përfundim, me të drejtë ka vlerësuar kjo Gjykatë, se ndodhemi para një greve dhe se duhen vlerësuar kriteret e ligjshmërisë së saj sipas nenit 197/1, të Kodit të Punës”.

Sa i takon ankimimit të palës së paditur në lidhje me arsyetimin e Gjykatës së Shkallës së Parë përsa i përket e ligjshmërisë së grevës, Gjykata e Apelit, çmon se edhe këto pretendime janë të pabazuara, pasi nga ana e Sindikatës janë shkelur të gjitha dispozitat ligjore që normojnë ligjshmërinë e grevës: nenet 169/2, 188-194, 193/7-197/5, 196/7, 197/3 etj, të Kodit të Punës, të ndryshuar, duke arsyetuar lidhur me cënimin e secilit nen nga ana e palës së paditur.

Në përfundim të arsyetimit të saj, Gjykata e Apelit Durrës, pasi ka shqyrtuar aktet e dosjes gjyqësore, si dhe në analizë e vlerësim të shkaqeve të ngritura në ankim nga ana e palës së paditur, ka çmuar se vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, lidhur me vlerësimin si të paligjshme të grevës së organizuar nga FSPISH, është rezultat i zbatimit të drejtë të ligjit dhe si të tillë e ka lënë në fuqi.

Ndër të tjera, Gjykata ka arsyetuar se: *“Kërkesat e pretenduara nga Sindikata në grevën e datës 26.05.2021, janë kërkesa të cilat vijnë në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Punës, me kontratën kolektive të punës që vetë palët kanë nënshkruar me vullnet të dyanshëm, e me aktmarrëveshjen e lidhur për reformën e fuqisë punëtore. Fakti që pala e paditur ka kërkuar nëpërmjet grevës, në vitin*

2021 të respektohet kontrata e punës e vitit 2013, kjo me të drejtë është vlerësuar një kërkesë absurde, pa bazë ligjore, e paparashikuar nga palët në asnjë akt ligjor të nënshkruar prej tyre, apo fakti tjetër, që pala e paditur ka kërkuar anulimin e reformës së fuqisë punëtore së nisur nga pala paditëse në mesin e zbatimit të saj, kur tashmë kishte përfunduar me sukses faza e parë e kësaj reforme, bazuar në aktmarrëveshjen e datës 26.02.2020 të nënshkruar nga vetë palët. Pra, sipas aktmarrëveshjes së mësipërme, kanë qenë vetë palët, edhe ajo e paditur, që kanë shfaqur vullnetin për kryerjen e ristrukturimit nëpërmjet shkurtimit të fuqisë punëtore për shkak të zhvillimit të teknologjisë, aktmarrëveshje e cila dhe është ekzekutuar me sukses dhe pa kontestim në fazën e parë, nga dy faza të parashikuara nga palët. Pala e paditur nuk ka dhënë asnjë argument ligjor se përse në këtë fazë të ndërmjetme të zbatimit të aktmarrëveshjes, duke anuluar reformën e dakordësuar nga dy palët dhe mënyra e zbatimit të saj.

Gjykata e Apelit vlerëson se edhe kushti tjetër i përcaktuar në dispozitat e Kodit të Punës për t'iu drejtuar Ministrisë të Ekonomisë dhe Financave është shkelur prej palës së paditur, pasi rezultoi se kjo palë i është drejtuar Ministres së Ekonomisë dhe Financave me datë 24.05.2021 dhe procedurat e ndërmjetimit kanë filluar me datë 28.05.2021, ndërsa greva ka filluar me datë 26.05.2021.

Vetë pala e paditur, paralelisht, pa pritur përfundimin e bisedimeve ka proçeduar me braktisjen e punës dhe fillimin e grevës, ndërkohë që Kodi i Punës i ka të mirëpërcaktuara hapat dhe afatet për zgjidhjen e çështjes me ndërmjetësim, fakt ky që dhe ka legjitimuar ngritjen e padisë dhe përfshirjen e çështjes në juridiksionin gjyqësor.

Rezultoi se greva është ushtruar pa përmbushur kërkesat e posaçme të Kodit të Punës, si dhe është zhvilluar në një sektor që hyn në kategorinë e sektorëve me rëndësi jetike. Në këtë gjykim, nëpërmjet masave disiplinore të aplikuara nga pala paditëse ndaj punonjësve të përfshirë në grevë, provohet plotësisht ndërprerja e punës prej tyre, ku kjo ndërprerje ka qenë edhe në pozicione pune të një rëndësie të veçantë në funksionimin e punës brenda llojit të aktivitetit të Shoqërisë Kërim International sh. a”.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, vendimmarrja e Gjykatës e cila është e formës së prerë dhe ka vendosur mbi paligjshmërinë e grevës, afekton në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe vlerësimin që do t'i bëjë KMD, pretendimeve të dy subjekteve ankues, M. N dhe A. R, lidhur me masat disiplinore të dhëna kundrejt tyre nga ana e Shoqërisë, pasi ato janë dhënë pikërisht për shkak të pjesëmarrjes në këtë grevë, të konsideruar si të paligjshme nga ana e punëdhënësit dhe konfirmuar nga ana e Gjykatës.

Në këtë logjikë, Komisioneri vlerëson se, përse kohë greva është konsideruar e vlerësuar si e paligjshme nga ana e Gjykatës, për rrjedhojë edhe pretendimet e ankuesve se masat e dhëna ndaj tyre për pjesëmarrje në një protestë dhe jo grevë, nuk qëndrojnë pasi janë të pabazuara në prova, fakte e ligj.

Mbështetur në sa më sipër, si dhe në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se subjektet ankues Mark Ndoj dhe Anton Rica, nuk i janë nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e

punëdhënësit, lidhur me dhënien e masave disiplinore dhe pezullimin e tyre deri në përfundimin e grevës, për shkak të pjesëmarrjes së tyre në grevën e datës 26.05.2021.

Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e shoqërisë Kërüm International sh. a, kundrejt dy subjekteve ankues, ardhur për shkak të përkatësisë në grup të veçantë të tyre, lidhur me dy momentet sipërcituar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e pretendimit të subjektit ankues A. M, pasi nëpërmjet Deklaratës Noteriale nr. 256 Prot., Nr. Kol. 663, datë 29.03.2022, ai e ka zgjidhur me mirëkuptim kontratën e tij të punës me punëdhënësin dhe ka hequr dorë në mënyrë të vullnetshme nga çdo pretendim në lidhje me punësimin dhe/ose të drejtat e tjera ndaj Kërüm International sh.a.
2. Konstatimin e mosdiskriminimit të subjekteve ankues, M. N dhe A. R, në fushën e punësimit, nga ana e shoqërisë Kërüm International sh. a , për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë të tyre, si pjesëtarë të Federatës së Sindikatave të Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha: Punësim
Shkaku: Përkatësia në një grup të veçantë
Lloji i vendimit: Mosdiskriminim